



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL
DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Tiranë, më 24.04.2019

**NJOFTIM MBI REZULTATET E VERIFIKIMIT PËR POZICIONIN E SHPALLUR,
SPECIALIST INFO-APLIKIM PËR AGROPIKAT**

Mbështetur në Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, (i ndryshuar), në zbatim të Urdhërit nr. 20 datë 19.01.2018, të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, “Për krijimin e sporteleve unike të shërbimeve për fermerët – “Agropika”, dhe të Urdhrit nr. 140, datë 17.09.2018 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, si dhe në njoftimin për vendet vakante në Agropikat, si dhe Njoftim Punësimi nr. 1106 prot., datë 27.03.2019 dhe Njoftim Punësimi 1106/3 prot., datë 29.03.2019 shpallur në faqen zyrtare të AZHBR-së, për Agropikat: Lezhë – Sarandë – Elbasan – Librazhd- Pukë, pas përfundimit të verifikimit të kandidatëve, për përmbushjen e kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim, njofton se për grupin e pozicioneve:

1. Specialist Info-Aplikim, Agropika – Lezhë
2. Specialist Info-Aplikim, Agropika - Sarandë
3. Specialist Info-Aplikim, Agropika - Elbasan
4. Specialist Info-Aplikim, Agropika – Librazhd
5. Specialist Info-Aplikim, Agropika - Pukë

Kandidatët e kualifikuar për të vazhduar fazën e dytë të konkurrimit janë:

1. Ermelinda Ndreca, Lezhë
2. Ardit Elezi, Lezhë
3. Natasha Berdufi, Elbasan
4. Dritan Kuci, Elbasan
5. Alban Preci, Elbasan
6. Altin Dranga, Elbasan
7. Ervis Sejdini, Librazhd
8. Mariglen Hoxha, Librazhd
9. Sabrina Kasemi, Sarandë
10. Haristo Mallanezo, Sarandë

Shënim: Kandidati Gjelo Gjelo, i cili ka aplikuar për Agropikën Pukë, skualifikohet.

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”.
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 37/2015, "Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II).
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9367, datë 7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- Njohuritë mbi VKM nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar.

- A. Testimi me shkrim do të zhvillohet në datën **26.04.2019, ora 9.00**, në ambientet e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, Rruga “Muhamet Gjollesha”, Nr. 56, Tiranë.
- B. Intervista e strukturuar me gojë do të zhvillohet në datë **26.04.2018, ora 12:00** në ambientet e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, Rruga “Muhamet Gjollesha”, Nr. 56, Tiranë.

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL